

unë jam

Histori suksesi të punësimit
të personave me aftësi të kufizuara



**Vodafone
Albania
Foundation**



unë jam

**Histori suksesi të punësimit
të personave me aftësi të kufizuara**

Ky botim është përgatitur në kuadër të projektit **“Punësimi i personave me aftësi ndryshe”** financuar nga **Fondacioni Vodafone Albania** dhe zbatuar nga **Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK)** gjatë periudhës Qershor 2010 - Korrik 2011.

Ky projekt synoi dhe arriti të realizonte krijimin e një regjistri të dhënash për përfituesit në 5 zona të vendit, krijoi mundësi të reja për kualifikimin e tyre dhe lloji për punësimin e tyre. Vetëm në sajë të këtij projekti, 20 persona me aftësi të kufizuara u punësuan. Në këtë libër përfshihen histori suksesi nga impakti i këtyre përpjekjeve, si dhe shembuj të tjerë frymëzues të punësimit të personave me aftësi të kufizuara.

Shënim:

Në respekt të të drejtave të individit, si dhe vlerësimit të aftësive të verifikuara gjatë zbatimit e kësaj iniciative, termi *“aftësi e kufizuar”* i përdorur gjerësisht në literaturën përkatëse është zëvendësuar në këtë publikim me termin *“aftësi ndryshe”*.

Projekti grafik: Olsi Bocka

Fotografia: Pierluigi Giorgi

Shtypur në: Gent Grafik sh.p.k.

© Copyright 2011

E gjithë përmbajtja e këtij raporti dhe/ose ndonjë pjesë e tij janë subjekt që mbrohen nga ligji për të drejtën e autorit.







Kur ndër Morrëm këtë nismë një vit më parë, ishim shumë optimist që do arrinim të sfidonim vështirësitë e shumta dhe të krenoheshim me përpjekjet që bëmë për të sjellë së paku 20 histori suksesi që do lëviznin mëndjet dhe zemrat e shumëkujt. Nuk e dinim vërtet nëse do ia dilnim, po dinim që do bënim çka mundeshim për ta çuar këtë sukses akoma më tej.

Jemi të vetëdijshëm për vlerat që personat me aftësi ndryshe kanë dhe njohim aftësitë e talentet e tyre, ndonëse niveli i punësimit për ta mbetet ende shumë i ulët. Megjithë progresin e bërë, ekzistojnë barriera që i pengojnë ata kundrejt mundësive për punësim, arsimim e formim profesional. Jemi ndjerë të rrethuar e respektuar nga shumë partnerë e përkrahës në këtë sfidë. Janë ata që iu bashkuan këtij misioni në punësimin direkt të personave me aftësi ndryshe, duke kontribuar në integrimin e tyre në jetën sociale. Por do veçoja atë që na besoi i pari në këtë nismë, financuesin e kësaj iniciative, Fondacionin Vodafone Albania. Kemi patur një eksperiencë të gjatë në sajë të mbështetjes së këtij Fondacioni në një sërë nismash në përmbushje të nevojave të personave me aftësi ndryshe, por sigurisht punësimi i tyre ka qenë një nga sfidat më të forta.

Historitë e suksesit të prezantuara në këtë botim tregojnë më së miri se njerëzit me aftësi ndryshe duan dhe përpiqen fort për të qënë denjësisht pjesëmarrës e kontribues në ndërtimin e një shoqërie që u përket të gjithëve. Ato dëshmojnë se punësimi i personave me aftësi ndryshe mund të jetë një element i rëndësishëm jo vetëm për të punësuarin, por edhe për punësuesin. Mesazhet e personazheve në këtë libër tregojnë qartë se ato kërkojnë të zbulojnë mundësitë për të shpallur aftësitë për të cilat janë krenarë për të kontribuar në shoqëri dhe në jetën e tyre të përditshme. Këto histori janë vetëm fillimi i një rrugëtimi afatgjatë, ku të gjithë do ndihen palë e do të punojnë së bashku për të përmbushur detyrimet e shoqërisë ndaj personave me aftësi ndryshe.

Blerta Çani

Drejtoreshë Ekzekutive
FSHDPAK





Historitë e këtij botimi janë të shkruajtura me dashurinë dhe thjeshtësinë e personave me aftësi ndryshe, me ankthet dhe emocionet e bukura të ditës së tyre të pavarësisë.

Do dëshiroja që këto mesazhe të bukura jete të zgjojnë vëmëndjen e kujtdo, qoftë një drejtuesi institucioni apo artisti, e një menaxheri biznesi apo ministri, dhe e të gjithëve ne, pasi kështu mund të kuptojmë se çfarë force e vlere do t'i jepte skuadrës apo komunitetit kontributi i personave me aftësi ndryshe.

Së bashku me Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar u përpoqëm shumë në këtë sfidë jo të lehtë, dhe përtej numrit të 20 historive, sjellim për lexuesin një përmbledhje të disa shëmbujve suksesi. Kam besim se kushdo që do t'i lexojë do arrijë të kuptojë më mirë botën e ndjenjave e nevojave të personave me aftësi ndryshe, të kuptojë dëshirën dhe mundësitë e tyre për të jetuar suksesshëm si dhe pafundësinë e mundësive që ka gjithsecili për të bërë më shumë.

Suksesi nuk i përket një institucioni, apo një personi të vetëm. Suksesi i vërtetë do të jetë nëse arrijmë që secili prej nesh në ditët e ardhshme të mund të shtojë fletët e këtij libri dhe të themi krenarisht : "Po, e ndjej se do të bëj akoma më shumë!". Sfida vazhdon...

Albi Greva

Drejtor Ekzekutiv

Fondacioni Vodafone Albania

Anisa Proda

Tirane

“Unë dhe bota u ndjemë më pranë”

Shpesh, jeta ime i ngjet një oazi politikisht të paqëndrueshëm ku për parime dhe të drejta tërësisht publike, luftohet vetëm në mënyra individuale, ku investimet janë të rrezikuara ndërsa fitoret janë të të gjithëve dhe dështimet vetëm të tuat.

Përfundova arsimin e detyrueshëm në institutin e nxënësve që nuk shikojnë. Në kundërshtim të dëshirës së prindërve dhe mësuesve të mi, vendosa të ndiqja shkollën e mesme të përgjithëshme, gjë që të cilën shumëkush nuk e konsideron të përballueshme për një nxënës të verbër. E njëjta forcë më shtyu të shkoj edhe më tej, të studioj për shkenca politike, duke konkuruar për një degë të vetme. Përfaqësimi i Shqipërisë në edicionin e 4-t të Institutit Ndërkombëtar të Grave në Leadership dhe Çështje të Aftësisë së Kufizuar më nxiti të udhëtoja e vetme drejt SHBA-së, duke ndërruar avionet e duke kapërcyer shtetet në një fluturim 15 orësh. Si “e sapolëshuar” jashtë një globi të mbyllur, me frikën e së panjo-

hurës dhe me shpresën tek aftësia për komunikim, guxova sfidën e këtyre vështirësive. Por, u ktheva prej aty me një eksperiencë shumë të mirë dhe me pak më shumë besim në vetvete. Të gjitha këto do të ndihmonin që një ditë të ftohesha si trajnuese në Kampin e Rehabilitimit të organizuar nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Kjo ka qënë eksperiencia ime e parë profesionale. Dhe dalëngadalë, duke ecur në rrugën e këtyre eksperiencave të para, ndjeja se po rritesha profesionalisht. Çdo ditë ka qënë një hap përpara, që gjithnjë e më shumë më bënte të kuptoja se të mos kesh shikim, nuk do të thotë mungesë vizioni.

“Nuk do doja që kjo të ishte thjesht një mundësi pune për ty, por që të sillte një frymë të re, një kulturë të re për këtë institucion” - m’u drejtua vetë Kryetari i Bashkisë së Tiranës gjatë intervistës që pata gjatë punësimit tim të parë. Në atë çast kuptoja që duhet të isha sa më e saktë, efektive dhe të artikuloja më të mirën time. Kujtoj se inkurajimi që mora që nga ky takim ishte i madh. Më trishtonte fakti se atë ditë kur bëja të pamundurën për tu prezantuar sa më mirë, më mungonte makiazh i kujdesur apo këpucët me taka ashtu sikurse nuk ecja shpenguar. Nuk njihja askënd që kisha përballë, nëse ngurronte të më fliste apo jo. Përpiqesha të projektoja në mendje ndërtesën që më rrethonte, të



Anisa Proda, 22 vjec
*Punonjëse pranë Ministrisë së
Punës, Çështjeve Sociale dhe
Shanseve të Barabarta*

cilën s'mundja ta shihja. Shkallët mund të ishin tjetërkund dhe muret tjetërsoj, megjithatë duhet të përpiqesha që ta afroja projektimin tim me atë realin për të qenë sado pak e pavarur në lëvizje. Do të doja shumë ta festoja ditën time të parë të punës. Ndoshta do të vlen të festohej edhe nga të tjerë, pasi dyert kishin nisur të hapeshin dhe institucionet po fillonin të kuptonin detyrën se duhet të pranojnë në punë edhe njerëz me kufizime fizike. Dua të besoj se ky ishte një stacion i parë por i mbarë, i cili ka përpara një destinacion përtej probleme veti. Përmes detajeve të vockla të ditëve të mia, tashmë kam filluar të lexoj se unë dhe bota që më rrethon nisëm të afrohem. Sfida ime e re kërkonte të ishte në shërbim të kauzës për të cilën aktivizohesha prej kohësh. Me eksperiencën e fituar në Bashkinë e Tiranës, vendosa të aplikoja pranë Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Pas disa intervistave, më në fund mora lajmin e mirë të punësimit në këtë institucion, ku vazhdoj të punoj intensivisht edhe sot. E kam të vështirë ta përcaktoj nëse isha përpjekur shumë, kisha vepruar në çastet e duhura apo kisha pasur shansin të takoja njerëzit e duhur. Ndoshta gjëja e duhur ishte të bërit bashkë të gjithë këtyre faktorëve. Punësimi im brenda një kohe të shkurtër në dy institucione të rëndësishme mrekullisht ndodhi. Ka edhe njerëz të tjerë që nuk shohin, të arsimuar dhe me vullnet, por të pa punësuar. Sfida ime e radhës është të jem në shërbim të tyre.

Ardit Mancaku

Shkodër

“Dua të punoj e jetoj të ardhmen”

E veçanta rreth meje është se aftësia ndryshe më është bërë forcë që më afron me shumë njerëz. Ndihem shumë mirë mes tyre, dhe kënaqem kur edhe njerëzit ndihen mirë në skuadër apo në shoqëri me mua.

Përveç aftësisë ndryshe që në lindje, më shoqëroi dhe braktisja e prindërve. Ende sot jetoj në një shtëpi “familje”. Gjatë qëndrimit tim në Itali gjatë vitit 1991 të mundësuar me ndihmën e Motrave të Nënë Terezës, iu nënshtrova një operacioni që më mundësoi të ecja me paterica. E kujtoj këtë periudhë pasi jo vetëm më ndihmoi për të ecur, por aty mësova dhe praktikova mirë gjuhën italiane, me të cilën unë sot jam i punësuar. Tashmë jam punonjës pranë një kompanie private telemarketingu “Voice Star” në qytetin e Shkodrës. Si operator telemarketingu, bëj përp-

jekjet e mia për të kryer detyrat që më ngarkohen. Për t’u përgatitur cilësisht për punën, kam marrë pjesë në kurse kualifikimi për përdorimin e programeve kompjuterike. Tashmë ndihem shumë mirë me dijet që zotëroj dhe kompjuteri është gjithashtu një mik i mirë me të cilin ndaj një pjesë të mirë të ditës time. U ambjentova menjëherë me vendin e punës, me njerëzit që më rrethojnë. Kompania ofron kushte shumë të mira pune. Aty kam gjetur një komunikim dhe mikëpritje të ngrohtë nga kolektivi dhe kjo gjë më ka bërë të ndihem njëllor si gjithë të tjerët. Punoj krahas


shumë të rinjve të shkolluar dhe unë po përpiqem t’u tregoj atyre se jam i barabartë me ta.

Kam dashur gjithnjë të punoj, për një jetë si gjithë të tjerët, të jem në komunikim me njerëz të ndryshëm dhe pse jo, të krijoj mundësi për të jetuar edhe më mirë. Kujtoj shpesh emocionet që provova përpara se të filloja punë gjatë intervistave në Zyrën e Punës. U ndjeva mirë në intervistë sepse këtë ma ndihmoi komunikimi shumë i mirë me dy nëpunëset e Zyrës së Punës. Ato kishin një angazhim maksimal për të ndihmuar integrimin tim në tregun e punës.

Nga një njeri që ndihej i pashpresë e pa motive jetësore, tani ndihem i organizuar me orarin e punës, të ngrënies, të kafesë dhe të pushimit, ndihem njëllor si të tjerët. Ndjej kënaqësi dhe besim se kam përreth njerëz që më kujtojnë e që më ndihmojnë e më mbështesin. E gjithë kjo më bën shumë optimist për të ardhmen, pasi qëndrimi në shtëpi është izolim total nga jeta. Do të doja t’ju thoja edhe personave të tjerë me aftësi ndryshe që të mos demoralizohen, të luftojnë për veten dhe me kurajo të kërkojnë integrimin e tyre në shoqëri.



Ardit Mancaku, 32 vjec
Operator telemarketingu në
kompaninë "Voice Star", Shkodër



Klaudia Shehu, 20 vjec
*Punonjëse pranë sallonit të
parukerisë "Adelina", Elbasan*

“Ëndrra ime është të nis biznesin tim një ditë”

Më duket sikur kam rilindur. Kur fillimisht më kontaktuan, kuptova se diçka e mirë do të ndodhte dhe se jeta ime do merrte një drejtim të ri.

Deri atëherë shpresat për të ardhmen sikur më ishin fashitur pakëz. Kujtoj që telefonata për intervistën më ka entuziasmuar dhe më riktheu optimizmin. Besoja se diçka e mirë do ndodhte. Fatmirësisht në këtë botë ka dhe shumë njerëz të mirë, që nuk ngurojnë së ndihmuari personat me aftësi ndryshe dhe për këtë u jam shumë mirënjohëse atyre që u bënë shtysë në këtë iniciativë.

Nuk kam për ta harruar kurrë ditën kur shkova për herë të parë në punë. Shoqërohesh nga një i afërm dhe nga miq që më ndihmonin. Jam befasuar nga mikpritja e Adelina Ramës, menaxheres së sallorit të bukurisë “Adelina” në një prej lagjeve

të Elbasanit. Deri tani kam marrë shpesh përgëzimet e saj, të kolegeve, por sigurisht një kënaqësi e veçantë është kur përgëzimet e falenderimet vijnë nga vetë klientet për shërbimin e ofruar. Kjo është ndjenjë e natyrshme krenarie pasi këto janë shenja vlerësimi të atij kujdesi të madh që përpiqem t’i kushtoj çdo detaji në punën time. Angazhimi im në punë si parukiere jo vetëm që i ka dhënë gjallëri jetës time por duke qenë ambicioze në kualifikimin tim si profesioniste shpresoj të eci përpara në të ardhmen. Do doja shumë t’u tregoj të gjithëve se edhe personat me aftësi ndryshe mund të jenë punonjës të mrekullueshëm. Gjatë adoleshencës time kam qenë

druar në shtëpi, në një jetë tërësisht pasive dhe e mbyllur brenda mureve. Dita ime ishte si një rrugicë e zbrazur, ndërsa jeta pa asnjë kuptim apo shpresë për të ardhmen. Pas përfundimit të shkollës me rezultate shumë të mira në Tiranë, ndoqa me shumë përkushtim kurse të formimit profesional që sot më ndihmuan të jem këtu ku sot gëzoj në punën time. Nga kjo punë nuk kam përfituar vetëm profesionin, miqtë por edhe shumë më shumë se kaq. Dita ime sot është ndryshe. Unë besoj fort se me këmbëngulje dhe vullnet në këtë botë nuk ka gjë që nuk mund të arrihet. Ëndrra ime mbetet që një ditë të kem biznesin tim.

Kol Koleci

Shkodër

Kam studjuar që një ditë të isha në profesionin e mësuesit

Për të prezantuar veten, do doja që ju si lexues të viheni në rolin tim e të kuptoni që ëndrra ime sot është realizuar. Kur më thanë për herë të parë që do kryeja praktikën si mësues, kam provuar një emocion të rrallë e të pakrahasueshëm.

Harrova çdo përpjekje e sakrificë të mëparshme të dështuar, pa u menduar se jam lodhur. Duke qenë i verbër, kam punuar më shumë se të tjerët për të arritur ëndrrën time, për të realizuar pasionin tim, që të bëhesha një ditë mësues. Sigurisht, nuk varej vetëm nga pasioni dhe puna ime, por edhe se si shoqëria do e priste këtë sfidë timen, se si do e prisnin nxënësit e mi të ardhshëm. Kështu që ëndrra ime duhej të priste edhe për një shoqëri të emancipuar dhe gjithëpërfshirëse. Kam punuar me një zell të pandalur për te qënë sa më i mirëpritur nga të gjithë. Kujtoj me kënaqësi pritjen e veçantë nga ana e stafit pedagogjik dhe e nxënësve të shkollës 9-vjeçare "Pashko


Vasa" në Shkodër. Ajo ishte dhe vazhdon të jetë përherë e ngrohtë, njerëzore dhe profesionale. Ndonëse jam ende në momentet e fillimit të kësaj eksperience si mësues i lëndës së biologjisë, ndihem optimist për hartimin e një plani pune të mësimdhënies. Përveç të tjerave, kujtoj që kam përballuar edhe vështirësi. Nuk është e lehtë që të jesh mësues me aftësi ndryshe. Duke qenë se në kohët e sotme vihet re një tendencë uljeje në punën e familjes në mbështetje të edukimit të fëmijëve, kjo edhe për mua sjell të tjera sfida. Por, duhet të them se edhe këto vështirësi më japin shtypa për të bërë akoma më shumë për ta. Shpresoj shumë se me ekperiencën time në

këtë skuadër pedagogjike në të ardhmen do mirëprehen edhe persona të tjerë me aftësi ndryshe. Sot vazhdoj të kem përkujdesjen e bashkëshortes time të përkushtuar, krahas kujdesit që ajo ka ndaj dy fëmijëve tanë. Ndihem mirë pasi mendoj se kështu edhe unë tashmë kontribuoj për edukimin dhe të ardhmen e tyre. Do të doja ti thoja kujtdo që para se të gjykojë apo vlerësojë personat me aftësi ndryshe, për një çast të vendosin veten në rolin apo pozicionin e tyre. Do të doja gjithashtu t'ju thoja të gjithëve ta duan jetën, e të luftojnë për të. Ta kërkojnë vetë pasionin, dëshirën dhe punën, sepse ato i japin kuptim jetës.

BLIOTEKA E UNIVERSITETIT



Kol Koleci, 46 vjec
(25 vjet i verbër)
Mësues në shkollën 9-vjeçare
"Pashko Vasa", Shkodër

A woman with dark hair tied back, wearing glasses and a white uniform with a blue logo on the sleeve, is smiling at the camera. She is sitting at a desk in a call center. In the background, another person is visible working at a computer. A microphone is visible in the foreground on the left.

Odeta Hazizolli, 25 vjeç

*Punonjëse në kompaninë e telefonisë
celulare Vodafone Albania*

“Puna të bën të jetosh e pavarur dhe me forcat e tua”

Kur vjen e premtja e pres me padurim pushimin e fundjavës, por ama të djelën më vjen sërish natyrshëm dëshira që të kthehem në punë.

Në punë ndihem shumë mirë, kam kontributin dhe përgjegjësitë e mia, kam kolegët që tashmë janë dhe miqtë e mi, dhe kam një jetë si çdo person tjetër.

Ndonëse ditën kur mora lajmin e punësimit në kompaninë Vodafone Albania isha ende në fazë rehabilitimi pas një ndërhyrje kirurgjikale, më pushtoi gëzimi dhe nuk prisja dot deri sa të filloja. Nuk arrija ta besoja. Fillimisht, në muajin e parë kalova periudhën e provës ku herë pas here më shoqëronte ankthi për të justifikuar besimin e dhënë. Por shpejt u mësova dhe çdo gjë ishte e thjeshtë dhe aspak e vështirë.

Që prej aksidentit që pësova në vitin 2001, isha mësuar që të kisha pranë

përherë patericat dhe nënën time. Por sot kam shumë më shumë. Kam ndërë mikpritjen e kolegëve që në ditën e parë, të cilët më kanë ndihmuar në çdo hap. Sigurisht që krijimi i mundësive për të provuar dhe testuar aftësitë e mia është shumë i rëndësishëm, por edhe ndihma që mu ofrua për të kuptuar programin, rregullat, procedurat, duke më orientuar për mënyrën se si duhej të punoja ishte gjithashtu e rëndësishme. Ajo që më duket e veçantë në tërë eksperiencën është se jam ndjerë e vlerësuar, jam konsideruar si gjithë punonjësit e tjerë, e barabartë me ta. Këtë e dëshmon dhe fakti që në këtë kompani janë krijuar të gjitha kushtet ambjentale për komoditetin e punësimit të personave me aftësi

ndryshe.

Do të kërkoja që njerëzit të përpiqen të shohin e të njohin cilësitë dhe dhuntitë e personave me aftësi ndryshe, t’u japin atyre mundësi për ti vënë në provë dhe t’ju ofrojnë shanse të njëjta si për gjithë të tjerët. Do gjejnë shumë më shumë se ç’presin. Por jo vetëm të kërkojnë nga shoqëria, por edhe vetë personat me aftësi ndryshe duhet të kërkojnë dhe të japin më shumë prej vetes, të investojnë tek vetja, nëpërmjet arsimit dhe formimit profesional. Të kërkojnë e të gjejnë punë sot është një vështirësi shumë e madhe për këdo. Për personat me aftësi ndryshe kjo kthehet në një sfidë të vërtetë. Une ia dola dhe do doja të shihja edhe shumë të tjerë të buzëqeshin si unë.

Bukurie Maloku

Elbasan

“Me këmbëngulje e vullnet nuk ka gjë që nuk mund të arrihet”

Dëshira ime për punën më bën që të udhëtoj çdo ditë 8 km për të gëzuar në ditën time të punës.

E shoqëruar nga mamaja, e nis mëngjezin me shumë optimizëm që nga fshati Mengël i komunës Labinot Fushë, e deri tek studioja ku punoj në qendër të qytetit të Elbasanit. Gjithçka filloi disa muaj më parë, kur në degën e Shoqatës të të Verbërve të Shqipërisë ku aderoj na vizitoi gazetari i njohur Fatmir Popja. Gjatë bisedës me të mbi punësimin e personave me aftësi të kufizuar, u ndalëm gjatë mbi mundësitë, dëshirat dhe kushtet e këtyre personave. Aty u njoha edhe me iniciativën e Fondacionit Shqiptar

të të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar mbështetur nga Fondacioni Vodafone Albania që tentonte nxitjen e punësimit për ne. E gjithë kjo përputhej shumë me dëshirën time, dhe që në atë çast fillova të endërroja për të punuar në studion e radios. Mund të imagjinoni kur Fatmiri më kontaktoi më pas për të më ftuar në studio për të punuar me të. Ishte realizimi i një ëndrre që kisha kaq kohë që e prisja. Kisha emocione në fillim, por më pas arrita që t'i kthej në energji pozitive. Dita e parë rezultoi ashtu siç

e kisha imagjinuar. Të veçantë nga kjo ditë mbaj mend urimet e shumta që më vinin prej dëgjuesve për fillimin e punës.

Në fakt, nuk ishte qëllimi im i vetëm të arrija të kisha punën time, por doja dhe dua që nëpërmjet saj të bëj më shumë, e që kjo t'i vlejë të gjithëve, personave me aftësi ndryshe e jo vetëm atyre. Emisioni që drejtoj titullohet “Përmes sfidave të jetës”, dhe përqëndrohet mjaft në problematikën e personave me aftësi ndryshe si edhe problemet sociale që lidhen

me to. Shpresoj që nëpërmjet këtij emisioni të kem ndikuar tek dëgjuesit por dhe tek ekipi ku unë punoj. Doja të përmendja se kolegët në studio kanë shumë besim në punën që bëj dhe më konsiderojnë si të barabartë. Shpesh herë më nevojitet ndihma e tyre për të perballuar pengesat gjatë punës, siç është për shembull leximi i mesazheve të dëgjuesve.

Të gjitha aftësitë që sot aplikoj në punë i dedikohen dhe studimeve që kam pasur gjatë viteve. Pasi ndoqa programin arsimor në insititutin për personat me aftësi të kufizuar në shikim, megjithë vështirësitë për mungesën e teksteve në "brail" vazhdova studimet në Gjimnazin "Qemal Stafa" në Elbasan. Më tej, vijuan studimet në Universitetin "Aleksandër Xhuvani" si dhe disa kurse kualifikuese të cilat më forcuan njohjet dhe kapacitetet për të qenë e zonja për të bërë më shumë për vete dhe për të tjerët. Ndërsa "ëndrra ime në sirtar" mbetet punësimi si mësuese. Megjithëse shpesh është premtuar nga strukturat përkatëse, kjo mbetet një objektiv për të ardhmen. Besoj fuqimisht që do e arrij një ditë ëndrrën time. Do përpiqem parreshtur për të.



Bukurie Maloku, 36 vjeç
Punonjëse në radio Klea, Elbasan



Artan Haruni, 40 vjeç

*Punonjës pranë Ndërmarrjes së
Pastrim-Gjelbërimt, Durrës*

“Të ndihesh i dobishëm”

Për askënd nuk është e lehtë për t’u punësuar, por veçanërisht për personat me aftësi ndryshe. Për këtë duhet të përpiqemi, të kërkojmë nga insitucionet dhe nga vetja.

Kam filluar të punoj në ndërmarrjen pyjore që i vogël. Isha 15 vjeç dhe që atëherë kam jetuar kënaqësitë dhe emocionet e punës. Pikërisht, në valën e këtij vrulli e dëshire për punën, u aksidentova. Përtej traumës së humbjes së njerit krah, duke u kthyer në një person me aftësi të kufizuara filloi një jetë krejt ndryshe nga ajo që unë bëja. Familja ime, edhe 4 fëmijët e mi ndonëse më ishin afër, nuk mund të më kthenin përsëri aty ku isha. Shkëputja nga puna e vështirësoi shumë gjëndjen ekonomike të familjes. Si kryefamiljar, ndjeja gjithmonë e më shumë peshën e përgjegjësisë për fëmijët e mi, ku tre prej të cilëve janë në moshë shkolle. Kufizimi fizik më ka penguar për shumë kohë të gjeja punë. Edhe kur merrja kurajon të kërkoja të punëso-

hesha, preferoheshin vetëm persona të shëndetshëm.

Kur papritur, pak muaj me parë m’u ofrua mbështetje për krijimin e mundësivë për punësimin tim. Ishte fillimisht një telefonatë, e më pas disa takime me përfaqësues të Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Zyrës së Punës në Bashkinë Durrës. Dalëngadalë, ndjeva se po realizohej më së fundi dëshira ime e madhe për punësim. Për më shumë, punësimi u realizua në të njejtën ndërmarrje ku unë kam punuar prej vitësh, ku kam kolegë, miq e të njohur.

Kisha ankthet e mia nëse do isha i zoti të përmbushja detyrimet dhe përgjegjësitë. Duhet të them se e pata të lehtë për t’u përshtatur me ambientin e punës, pasi jo vetëm që

për mua ishte një ambient i njohur më parë, por edhe se të gjithë më ofruan mbështetjen, për të cilën kisha aq shumë nevojë. Shumë shpejt mora instruksionet për mënyrën e funksionimit të punës dhe të rolit tim. Mu krijuan lehtësitë të punoj vetëm gjatë ditës dhe në një post pune që unë mund ta përballoja me shumë sukses e dedikim. Ekpserienca e përditëshme më shtyn të mendoj edhe për përmirësime në rolin tim dhe në vendin e punës. Për askënd nuk është e lehtë për t’u punësuar, por veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara. Për këtë duhet të përpiqemi, të kërkojmë nga insitucionet dhe nga vetja. Punësimi më bëri të ndihem përsëri i dobishëm. Dhe jo thjesht për veten, por edhe për familjen time të mirë.

Ervehe Tushe

Tiranë

“Mikpritja më dha forcë”

Kisha ëndërruar të punoja në një studio radio, kisha menduar për kënaqësitë që do mund të më jepte kjo eksperiencë, dhe tashmë këto pritshmëri janë realitet.

E mbaj mend, ishte ditë e hënë, 22 Mars kur po ngjisja shkallët e Radio Televizionit Shqiptar me ngathtësinë që më vinte nga emocionet që më prisnin në studion ku aq shumë kisha dashur të isha. Personit që më shoqëronte dhe i jepte drejtim hapave të mi, i shtrëngoja fort dorën sikur të doja të lexonte emocionet e mia. Atë që kujtoj nga ajo ditë ishte intervista e parë. Ishte vetë Nëndrejtori i Përgjithshëm i RTSH-së bashkë me drejtuesen e departamentit të programacionit. Gjatë bisedës me ta emocionet shpesh më përpinin, por mundohesha t'i fshihja sa mundesha. Shpejt erdhi surpriza e parë. Më futën direkt në transmetim gjatë emisionit në

Radio Tirana. Emocioni i ëndrrës time për të qenë në studio përzihej me pyetjen: “A do të mundesha?”. Por shpejt, gazetari që drejtonte emisionin, filloi të më quante kolege. E gjithë ajo mikpritje me gjallëroi dhe më dha kurajo për të ecur përpara.

Sot jam e lumtur pasi vetëm pak muaj pas mbarimit të diplomës, gëzoj kënaqësitë që më jep puna që bëj. Ndonëse kisha bërë përpjekje dhe aplikime të ndryshme prej muajsh, një mundësi e re u shtua kur mësova për nismën e Fondacionit të të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara.

Puna ime sot konsiston në realizimin e një emisioni radiofonik javor. Ajo çfarë

ka ndryshuar në ditën time është motivimi: ngrihem herët në mëngjes dhe përgatitem për punën, duke i dhënë një ngjyrim komplet të ri, energjik dhe pasionant ditës time. Falë mundësisë të kësaj eksperience, jam e përfshirë edhe në trajtimin e problematikave për personat me aftësi të kufizuara, duke i ofruar dëgjuesve në mbarë Shqipërinë aspekte të këtyre problematikave dhe duke pritur një përgjegjshmëri shoqërore akoma më aktive. Mikrofonit radiofonik është tashmë një mik për mua. Zërat e dëgjuesve po kthehen në domosdoshmëri të ditës sime dhe ato më bëjnë që të jem vazhdimisht në plotësim të njohurive të mija për të orientuar një përgjigje të saktë çdo pyetje që vjen prej tyre. Sigurisht, tashmë them me krenari që është zgjeruar edhe rrethi i miqve të mi.

Besoje se eksperiencia ime mund të tregojë se njerëzit me aftësi ndryshe punojnë e integrohen profesionalisht po aq mirë sa çdo person tjetër. Sigurisht, vullneti dhe dëshira e punëdhënësve për të krijuar hapësira është e rëndësishme, por dhe personat me aftësi ndryshe duhet të kenë besim të plotë tek vetja dhe të këmbëngulin në gjetjen e mundësive të reja për ta. Ata duhet të kujtojnë shprehjen e shkrimtarit të madh rus, Tolstoit: “Pa punë edhe talentet më të mëdhenj shuhen”. I jam mirënjohëse të gjithë atyre që kanë besuar në aftësitë e mia dhe më ndihmuar të gjej rrugën time.



Ervehe Tushe, 25 vjeç
Punonjëse pranë Radio
Televizionit Shqiptar

Enver Shtojna, 37 vjeç
*Operator telemarketingu në
kompaninë "Voice Star", Shkodër*



“Si të gjithë të tjerët”

Dita ime tashmë fillon me rritëm e plot kënaqësi. Është shumë bukur teksa përshëndetem e flas me njerëzit. Në sajë të punës ndihem i përfshirë, i respektuar dhe mes shumë miqsh. As dita e pushimit nuk më pëlqen, pasi ndjej dëshirën për tu angazhuar vazhdimisht.

Pas aksidentit që pësova në vitin 1994 ku humba dhe njerën prej gjymtyrëve, jam përpjekur vazhdimisht të gjej mundësi punësimi. Me mbështetjen e familjarëve të mi dhe të spitalit të Shkodrës, iu nënshtrova një operacioni të sofistikuar. Bashkë me aksidentin, humba edhe mundësinë e punësimit dhe të ardhurat që vinin prej punës time. Në fakt, ka qenë e vështirë për mua të punësohem. Pavarësisht dëshirës dhe vullneti tim për punësim, punëdhënësit nuk kanë qenë të bindur se

gjendja fizike do më lejonte të punoja mirë. Unë nuk u dorëzoza. Nëpërmjet Fondacionit të të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar m'u dha mundësia të hyja në një fazë prove si operator telemarketingu në një kompani private. Shpejt mu ofrua dhe kursi disajavor i kualifikimit. U gëzoza shumë kur më vonë më komunikuan që prova ishte e suksesshme. Kisha fituar një vend pune! Kujtoj që në ditën e parë të punës dhe kur prekja kompjuterin më dridheshin gishtat. Ndërsa sot ndjej rritje të vazh-

dueshme profesionale. Mësoj e kuptoj ato që më parë nuk i dija. Pa punën kisha një jetë monotone ndërsa tani jam i rrethuar nga njerëzit. Në punë kemi një respekt të vazhdueshëm për njeri-tjetrin dhe ky respekt mua më bën të ndihem i privilegjuar. Bashkë me mua gëzon dhe familja ime, edhe fëmija im. Do të doja t'ju thoja të gjithë personave të tjerë me aftësi ndryshe që të kenë kurajo dhe optimizëm. Ja vlen të luftosh për gjithpërfshirjen duke parë gjithmonë drejt të ardhmes.

Valmira Bregu

Korçë

“Mes njerëzve që më duan e i dua”

Po i shkruaj keto rreshta bashkë me vajzën time Megi që më është përherë pranë meje dhe bashkëshortit sa herë që është e nevojshme për të na ndihmuar.

Po i shkruaj keto rreshta bashkë me vajzën time Megi që më është përherë pranë meje dhe bashkëshortit sa herë që është e nevojshme për të na ndihmuar. Ndonëse bashkëshorti im është ende i papunë, sot në familje time falë punësimit tim ka më shumë gjallëri, më shumë gëzim dhe më shumë për të bërë. Të gjithë ndihmojmë të gjithë, qoftë dy fëmijët dhe ne më të rriturit. Kam dashur vazhdimisht të isha e përfshirë në punë, jo vetëm sepse kjo do përmbushte në një mënyrë një pjesë të nevojave financiare, por edhe që të kishte mundësi të isha mes njerëzve dhe përgjegjësive qytetare. Kujtoj që prisja me ankth se si do të ishte puna që më priste pasi u njoftova

nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Kisha menduar e pritur shumë atë ditë. Por vetëm kur u gjenda aty kuptova klimën shumë pozitive që ofrohej nga të gjithë. Jam munduar që besimin që më dhanë duke më punësuar në rrobaqepësi, ta ktheja në përkushtim e dedikim. Sigurisht, në punën time ka patur shumë rëndësi mbështetja që më dha personi përgjegjës që më është përherë afër, por edhe pritja shumë e mirë nga koleget e tjera. Është e vërtetë se tani kam më pak kohë për t’u argëtuar dhe për t’u çlodhur, por unë ndihem mirë me skuadrën dhe personelin ku punoj. Qëllon shpesh vë buzën në gaz teksa mendoj

“po pse s’më qorton kurrë përgjegjësja ime, apo ndoshta sepse nuk dëgjoj?”. Po nga ana tjetër, ndihem shumë mirë teksa kam marrë vlerësime pozitive për punën, cilësinë dhe korrektësinë në punë. Gjithashtu, ndihem mirë se krahas shansit të të pasurit e një pune, më është mundësuar edhe pjesëmarrja në veprimtari sociale me kolektivin ku punoj. Do doja t’u thoja personave të tjerë me aftësi të kufizuara se çdo vështirësi që del përpara të forcon për të ardhmen ndaj ia vlen ta shohim të ardhmen me optimizëm. Është shumë bukur kur gjendesh në shoqëri dhe njerëz që të duan, e sidomos kur ndihesh se edhe ti kontribon.



Valmira Bregu, 29 vjeç
*Punësuar pranë rrobaqepsisë
"Center Line", Korçë*

Elton Lleshi, 34 vjeç

*Punon prej 3 vitesh
në organizatën
World Vision Albania*



Elton Lleshi dhe Bledi Suxhe

Tiranë

“Më thoni që nuk është ëndërr”

“Jeta është aq e bukur, sa që ia vlen që edhe në një karrike me rrota të përpiqesh të bësh gjithshka: te jetosh, të luftosh dhe të fitosh mbi kufizimet e vështirësitë”

Eltoni tregon se ka mësuar të shkruaj e lexojë autodidakt me ndihmën e familjarëve, pasi e kishte të pamundur të ndiqte shkollën që nuk krijonte kushte të përshtatshme edhe për Eltonin si përdorues i karriges me rrota. Me dëshirën për të mos të qënë i izoluar u transferua në Tiranë ku shpesh vendosi edhe kontaktet me organizata të shoqërisë civile që punojnë për personat me aftësi të kufizuara. Vit pas viti, pjesëmarrja në kampet e rehabilitimit për përdoruesit e karrigeve me rrota shpejt u pasua me eksperiencë gjithnjë e më cilësore dhe më tej i besohet detyra e trajnerit. Sigurisht, ajo që do bënte një ndryshim të madh

në ditën e Eltonit ishte punësimi. Me rekomandim të FSHDPAK, organizata World Vision Albania pranoi në skuadrën e saj edhe Eltonin. Natyrshëm, dita ditës në punën e tij ndihmonte studimi dhe mësimet që kishte marrë më herët në organizata e institucione të tjera.

“E pata shumë të vështirë të besoja se do të intervistohesha për punësim – tregon Eltoni. U emocionova shumë para komisionit. Mungesa e eksperiencës më bënte të ndihesha sikur isha para gjykatësit. Nuk e besoja kur më telefonuan të më komunikoni se do filloja punë si recepsionit. Ndiheha si në ëndërr, isha njeriu më i lumtur” –

vazhdon ai.

Sot, Eltoni jo vetëm gëzon kënaqësinë e punës, e të trajtuarit si i barabartë, krenar për mundësitë për të mësuar e shkuar me tej, por ka edhe gëzimin e një familje të re e të bukur. Duke qenë se i pëlqen muzika dhe sporti, atë e sheh shpesh mes miqsh duke kënduar, apo edhe në ndonjë terren sportiv ku shkon për të luajtur basketboll. “Jeta është aq e bukur, sa që ia vlen që edhe në një karrike me rrota të përpiqesh të bësh gjithshka: te jetosh, të luftosh dhe të fitosh mbi aftësinë tënde të kufizuar. Me gjithë vështirësitë që kam hasur, ia kam dalë – shton Eltoni me buzagazin e tij të përherëshëm.

“Kolegët më respektojnë **njësoj si të tjerët** dhe kjo më bën të ndihem mjaft mirë dhe i vlerësuar.”

Tre vjet me parë Bledi hyri për herë të parë në zyrat e organizatës World Vision Albania. Në ditën e parë, menaxherja e burimeve njerëzore e shoqëroi ngado për ta prezantuar me skuadrën dhe punën. Ishte një ditë e veçantë që ai e kujton veçanërisht për pritjen e ngrohtë që iu bë nga të gjithë. Që nga ai moment, ky staff dhe misioni i kësaj organizate u bënë pjesë e ditës së Bledit. “Kolegët më respektojnë njësoj si të tjerët dhe kjo më bën të ndihem mjaft mirë dhe i vlerësuar. Të qenurit i punësuar më ndihmon jo vetem financiarisht, por ajo që për mua ka shumë rëndësi është impakti social. Nuk kam fjalë të shpreh mirënjohjen time për FSHDPAK që më orientoi në punësimin tim.” – tregon Bledi.

Ambjentet e brëndshme të zyrave

janë të përshtatura dhe përgjithësisht ai nuk gjen vështirësi të mëdha me lëvizjen. Por përtej çdo vështirësie, Bledi vazhdon punën dhe përpiqet të bëjë më të mirën e tij. Pas tre vitesh të një modeli të suksesshëm punësimi, Bledi beson se shembulli i tij i shërben edhe vetë shoqërisë për të kuptuar e njohur atë pjesë të saj që kërkon të jetë aktive dhe që është e gatshme të demonstrojë se mundet për të qenë e vlefshme në jetën e përditshme. “Shpresoj shumë që nëpërmjet shëmbullit tim edhe persona të tjerë të kuptojnë rëndësinë e punësimin. Të kuptojnë vlerat që sjellin tek skuadra apo kolektivi prania, kontributi dhe i një personi me aftësi ndryshe, të kuptojnë se çfarë ndryshimi do sjellë punësimi në jetën e një personi me ndryshe” – shton Bledi.



Bledi Suxhe, 28 vjeç
*Ashtu si kolegu i tij punon
prej 3 vitesh në organizatën
World Vision Albania*



Gëzim Metaliaj

Tiranë

“Optimizmi ma bën më të plotë ditën time”

“Të jesh i punësuar është një mbrojtje e fortë ndaj realitetit të egër ekonomik në kohët kur jetojmë. Natyrshëm e shikon jetën më me optimizëm, dhe e gjithë kjo ndikon fuqishëm edhe në gjendjen shpirtërore e emocionale”

Ka lënë pas kujtimet e vitit të mbarshtë '97 që i shkaktoi dhe aksidentin me pasojat e tij dhe sot është një shëmbull i suksesshëm punësimi. Disa vite më parë, me këmbënguljen e tij, Gëzimi iu fut përgatitjeve për konkursin e punësimit pranë Fondacionit “YAPS”. Mes 300 pjesëmarrësve u përzgjodhën 27, prej të cilëve Gëzimi ishte vlerësuar i gjashti për nivelin e njohurive dhe aftësisë në përdorimin e kompjuterit dhe gjuhëve të huaja. Karakterizohet nga dëshira dhe kurioziteti për të renë, duke përshtatur mundësitë fizike, madje duke synuar shpesh edhe të pamundurën. Për

këdo nuk do ishte e lehtë për të siguruar vendin e punës, por aq më shumë për një person me aftësi ndryshe. “Fillimet kanë qenë të vështira. Nuk mendoja se do isha në gjendje të bëja atë që pritej prej meje. Pyesja veten se a do mund ta vazhdoja me sukses atë punë? A do mund ta përballoja transportin apo pengesat e tjera? A do mund të përshtatesha duke mposhtur edhe ndikimin e opinionit, që për hir të së vërtetës shpesh është jo shumë dashamirës ndaj personave me aftësi ndryshe” – mendonte shpesh Gëzimi në ditët e para të punës në “YAPS”. Aftësia fizike nuk ka qenë asnjëherë

pengesë për sytë e atyre që i ofruan të ishte pjesë e stafit. Ka patur disa vende të ndryshme pune në “YAPS”, që më tej i dhanë atij forcën dhe mundësinë të përfshihet edhe në disa eksperiencë të tjera punësimi. Në listën e punëve, Gëzimi përmend përveç Fondacionit “YAPS” edhe eksperiencën si operator transkriptimi dhe redaktimi për seancat parlamentare në Kuvendin e Shqipërisë; përfshirjen në hartim projektesh e trajnues informatike pranë Shoqatës së Invalideve Para dhe Tetraplegjikë; eksperiencë në organizimin e kurseve të informatikës tek Universiteti

“Vitrina”, si dhe bashkëpunime me qëndrën e internetit “Infopoint”. Nje tipar tjetër i rëndësishëm për Gëzimin është dhe pasioni për leximin dhe të mësuarit. Përveç punës, ai dëshiron të mbetet në kontakte me mundësi të reja për formimin profesional. “Pajtohem me idenë e të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe ngelem i hapur ndaj eksperiencave të reja” – shton Gëzimi. Pavarësisht disa përmirësimeve në infrastrukturë, barrierat mbeten gjithsesi një pengesë e vazhdueshme për Gëzimin dhe shumë të tjerë. Kërkohej të rritet më shumë ndërgjegjësimi i opinionit, i bizneseve dhe kryesisht i politikanëve për punësimin e personave me aftësi ndryshe. Egzistojnë ligje që në institucione shtetërore apo edhe biznese të ndryshme sanksionojnë mundësinë e punësimit për persona me aftësi ndryshe, por për fat të keq kjo mbetet në nivele shumë të ulta zbatimi. Me optimizëm për të ardhmen e shumë të tjerëve, na mjafton të lexojmë nga eksperiencat e suksesshme të disa prej atyre që guxuan dhe ia arriten, pikërisht në ato eksperiencat ku bën pjesë dhe historia e Gëzimit. “Të jesh i punësuar është një mbrojtje e fortë ndaj realitetit të egër ekonomik në kohët kur jetojmë. Të jesh në marrëdhënie pune si person me aftësi ndryshe është një terapi me vete. Natyrshëm e shikon jetën më me optimizëm, dhe e gjithë kjo ndikon fuqishëm edhe në gjëndjen shpirtërore e emocionale”- tregon Gëzimi.



Gëzim Metaliaj 32 vjeç
Gjatë punës së tij si monitorues i mediave
pranë fondacionit “YAPS”, Tiranë



Valbona Kraja, 30 vjeç
*Punësuar prej tre vjetësh në Qendrën
Kombëtare të Mirëritjes, Zhvillimit,
dhe Rehabilitimit Fizik të fëmijëve*

“Jeta është sfidë”

“Filloje ndryshimin nga vetja, thyej barrierat personale, ngrije zërin fort që të dëgjojë veshi yt sot dhe nesër të dëgjojë familja, komuniteti, shoqëria, shteti. Jeta merr kuptim kur ti sjell ndryshime të vogla të cilat zmadhohen dhe që nesër shumëfishohen.”

Ndër sfidat e saj, Valbona do të dëshironte të veçonte një eksperiencë shumë të veçantë, atë të punësimit të saj në Danimarkë. Ishte puna e saj e parë, dhe çdo gjë përballej për herë të parë: që nga shkëputja nga familja, udhëtimi me avion, mënyra e të punuarit, vendimarrja dhe përgjegjësitë. Shumë sfida njëherësh dhe krejtësisht të reja për Valbonën, porse të shoqëruara me ëndrra e pritshmëri e një studenteje që sapo ishte diplomuar e që hidhte hapat e para profesionale në një vend si Damianarka. Ishte një vit shumë intensiv, ku i duhej gjatë gjithë kohës të mësonte. Nuk i mungonte përkrahja dhe mbështetja nga të gjithë dhe kjo ia lehtësonte çdo vështirësi. Pas përfundimit të këtij viti, ajo vinte me

një forcë të madhe e me kurajo për të gjetur edhe në vendin e saj mundësi të reja. Por kthimi në vendlindje e përballoi me një realitet krejtësisht tjetër nga ai që kishte lënë në Danimarkë. Tashmë sfida bëhej e fortë. Me mbështetjen e Ministrit të Shëndetësisë, iu krijua mundësia të punonte si punonjëse sociale në Qendrën Kombëtare të Mirërritjes, Zhvillimit dhe Rehabilitimit të fëmijëve. Fillimi ishte i vështirë sepse u ndesh me paragjykime dhe një kulturë mospërfshirjeje. Përshtatshmëria infrastrukture, mjetet e transportit publik përbënin gjithashtu probleme për t'u përballuar. Puna, përkushtimi, korrektesia dhe ngritja e marrëdhënieve korrekte me kolegët si dhe prindërit

e fëmijëve ishin gjithashtu një sfidë madhe. Por me kalimin e kohës Valbona është bërë model pozitiv për nënat që kanë fëmijë me probleme dhe jo rrallë janë ato që kërkojnë këshillim e mendime, kërkojnë një përgjigje tek e cila të mbështeten dhe të shpresojnë që edhe për fëmijën e tyre do të ketë përmirësim. Kur e pyetëm Valbonën se ç'këshillë do t'u jepte miqve të saj, ajo përgjigjet: “Për ty mik me aftësi ndryshe, do të thosha filloje ndryshimin nga vetja, thyej barrierat personale, ngrije zërin fort që të dëgjojë veshi yt sot dhe nesër të dëgjojë familja, komuniteti, shoqëria, shteti. Jeta merr kuptim kur ti sjell ndryshime të vogla të cilat zmadhohen dhe që nesër shumëfishohen. Jeta është sfidë.”

Dritan Hoxha

Elbasan

“Mirë se erdhët, si mund t’ju ndihmoj?”

“Lashë me shumë dëshirë statusin e personit me aftësi ndryshe bashkë me paketën e asistencës, për të zgjedhur statusin e nëpunësit civil sepse doja të ndihesha i barabartë mes të gjithëve.”

Metalurgu i dikurshëm, kishte pasione të ndryshme dhe një prej tyre ishte biçikleta. Por 20 vjet më parë, pikërisht duke i dhënë bicikletes ndodhi aksidenti që do ta ulte në karrige me rrota. Pas një traume të tillë për pothuajse 9 vjet Dritani pati një mbyllje në vetvete. Miqtë e vizitonin herë pas here. Nëna e tij i është përherë pranë me të gjithë forcën dhe mundësitë e saj. Dritani vlonte nga brenda me dëshirën për të dalë nga kjo gjëndje, dëshironte të ishte mes njerëzve. I nxitur për të ndryshuar ditën e tij, ai filloi të përshatasë makinën që kishte blerë me

qëllim të sigurote kontrollin e saj. Besonte shumë që me të jeta e tij do ishte aktive, do kishte mundësi të ishte i integruar në organizime e iniciativa ku edhe ai mund të jepte kontributin e tij. Makina i dha Dritanit një shkallë lirie e pavarësie të madhe, e ndihmoi të lëvizte e të takonte shumë njerëz, dhe jo vetëm kur ata e vizitonin, por kudo ku ato ndodheshin.

Me ndihmën e shoqatës “Në familje për familjen” dhe me mirëkuptimin e pritjen e mirë të Bashkisë Elbasan, u bë e mundur punësimi i tij në këtë institucion ku punon edhe sot e kësaj dite në

pozicionin e specialistit në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Publikun dhe Informacionit pranë këtij institucioni. Dalohet për sjelljen dhe korrektësinë në komunikim. “Një nga vëshirësitë e mia ishte plotësimi i kriterëve të arsimit të lartë. Lashë me shumë dëshirë statusin e personit me aftësi ndryshe bashkë me paketën e asistencës, për të zgjedhur statusin e nëpunësit civil sepse doja të ndihesha i barabartë mes të gjithëve” – na tregon Dritan. Natyrshëm, Dritani është bërë pjesë e jetës dhe punës së ekipit të këtij institucioni. Me ndihmën e FSHDPAK, janë bërë përpjekje që jo vetëm ai të mbështetet më tej në pozicione edhe më të specializuara brenda bashkisë, por edhe që shëmbulli i Dritanit të jetë udhërrëfyes për shumë të tjerë, në institucione të administratës, bizneseve, apo shoqërisë civile për të punësuar persona me aftësi ndryshe. Ai është optimist dhe bën përpjekje që të ndihmojë edhe miqtë e tij. “Eksperiencia e punësimit tim tregoi se ka nevojë të bëhen ndryshime në procedura, madje edhe përmirësime legjislacioni në mënyrë që të krijohen kushte dhe lehtësira të reja për punësim, gjë e cila do angazhojë si punëdhënësin ashtu edhe punëmarrësin me aftësi ndryshe” – shton Dritani.

Dritan Hoxha, 41 vjec
Specialisti i marrëdhënieve me publikun në Bashkinë e Elbasanit



Emiliano Lule, 30 vjeç
*Punon në departamentin e burimeve
njerëzore të kompanisë "Infosoft".*



Emiljano Lule

Fitues i Programit "Bota e Ndryshimit" 2010/11
i Fondacionit Vodafone Albania

Në përgjigje të nevojave të komunitetit tim

Është e rëndësishme të shikosh se shumëkush të jep buzëqeshjen, por është edhe më e rëndësishme të kuptosh se askush dhe asgjë s'është aq e rëndësishme që të të heqi buzëqeshjen!"

Ndërsa shkruaj këto rreshta, kujtoj që bëhen 10 vite që kam humbur shikimin. Mund të ishte ndryshe, por tanimë kjo nuk është tjetër veç një lojë fjalësh, të cilat më provojnë ekzistencën e realiteteve në të cilat kam jetuar dhe kam shpresuar se mund të ishte ndryshe. Për të gjithë ju që do lexoni këto histori njerëzore do doja t'ju rrëfej realitetet, përshtjellimin e ndjenjave, forcën dhe vetëbesimin, holokaustin apo dashurinë, vlerat që njeh e mbart qenia njerëzore, e që

më provojnë se këto realitete mund të jenë ndryshe. Mendoj se në institucionin e punësimit matet një nevojë e madhe, ajo për vlerësim, e cila për çudi megjithëse renditet më pak e rëndësishme në librat e psikologjisë që kam studjuar, është kaq kuptimplote kur flitet për komunitete të njerëzve me aftësi ndryshe. Këtë të fundit ndjej ta quaj mundësi të kufizuar. Ekzistojnë dy lloje mundësish të kufizuara: të padukshme dhe të dukshme. Unë kam jetuar dhe kam punuar në secilën

prej këtyre gjendjeve, brenda e jashtë Shqipërisë. Ruaj në memorien time momentin kur kam tërhequr rrogën e parë si njeri me statusin e mundësisë së kufizuar. E kujtoj këtë çast sepse më bëri të rinjoh veten, rigjej kuptimin për jetën.

Historia ime e punësimit tim të parë si i verbër ndoshta është vërtet e rrallë. Të jesh pjesë e një stafi të një spektakli televiziv dhe punonjës në një kompani Hi-Tech, ku shumëkush do donte të punonte, nuk është diçka

që ndodh shpesh. Disa e kanë konsideruar si histori suksesi. Në media e kanë etiketuar gjeniale, e në disa raste është paraqitur si model. Por për mua është e rëndësishme të ndaj me ju se besoj thellësisht se gjithkush mund t'ja dalë edhe me vështirësinë që mbart mundësia e kufizuar fizike. Në një reflektim personal kam kuptuar se një njeri nën stigmën e "paaftesisë" është gjeni vetëm kur gjen forcën të mposhtë inferioritetin dhe të pranojë veten për të rifilluar nga e para, qoftë edhe për të disatën herë.

Në kohën kur humba shikimin jetoja në "Qytetin Studenti", dhe aty kam vënë re shumë herë një djalë të verbër, portretin e të cilit e kam edhe sot në mëndje. Mbante një kapele dhe syze të zeza. Interesi im për të zgjaste vetëm 5 sekonda, koha që më duhej për t'u shkëmbyer në rrugë, madje mund edhe të ndjehesha në siklet kur qëndroja pranë më gjatë. Sot njoh shumë njerëz që në punën e tyre kanë në fokus përballjen me nevojat dhe integrimin e komuniteteve në të cilët bëj pjesë edhe unë, dhe të cilëve tanimë ju kushtoj edhe kontributin tim. Ka mëse një vit që punoj për programin "Bota e Ndryshimit", në zbatimin e një ideje inovative në teknologjinë e komunikimit të cilën ma besoi Fondacioni Vodafone Albania. Kam vendosur në qendër të kësaj sfide kontributin tim për një komunitet prej më shumë se 1200 individë të verbër në të gjithë Shqipërinë. Kam punuar me

përkushtim për përgatitjen e udhëzuesve në gjuhën shqipe për përdorimin e kompjuterit për të verbërit. Nuk do doja të flisja për emocionin që ndjeva kur më njoftuan se isha fitues. Që në vitin 2004 kisha një kërkues të madhe të punësoshesha në Vodafone. Në atë kohë do më lumturonte posti i një operatori të thjeshtë. Por do kalonin vetëm pak vite kur Bordi Drejtues i Fondacioni Vodafone Albania do vlerësonite fitues projekt propozimin tim. Ky është një motivim i bukur jo vetëm për të bërë maksimumin në realizimin e sfidës time, por jep shumë energji për të bërë akoma më shumë për të ardhmen.

Me mirënjohje do përmendja regjizoren e mirënjohur Vera Grabocka, ekipin e kompanisë Infsoft dhe Fondacionin Vodafone Albania për forcën e madhe që patën për të parë përtej asaj që duket, empatinë për të kuptuar e lexuar edhe "botën" time. Dikush më kishte thënë dikur ndërsa ecnim së bashku: "Çfarë vlere ka të fitosh besimin për të zbatuar një projekt me impakte sociale, të punosh në një kompani Hi-Tech apo në një televizion, madje të bëhesh edhe i famshëm kur nuk arrin të shikosh dhe t'u kthesh buzëqeshjen njerëzve në rrugë". Mbjaj mend që përgjigjia ime doli spontane: "Është e rëndësishme të shikosh se shumëkush të jep buzëqeshjen, por është edhe më e rëndësishme të kuptosh se askush dhe asgjë s'është aq e rëndësishme që të të heqë ty buzëqeshjen!"





Suela Lala

Fituese e Programit “Bota e Ndryshimit” 2010/11

Forca për ndryshim

“Forca e ndryshimit buron, zhvillohet e shpaloset brënda nesh. Ne të gjithë e kemi atë forcë, por shpesh edhe nuk e përdorim, ose thjesht nuk i japim rëndësinë e duhur. Sikur të gjithë të reflektonim kështu, shumë nga ato qëllime për të cilat sot luftojmë fort do ishin të realizuara.”

Kisha dëgjuar për programin “Bota e Ndryshimit”, prezantuar nga Fondacioni Vodafone Albania. Duhet të them se shëmbulli i zonjës Kospiri si fituese e vitit 2009/10 më dha nxitje që të përpiqesha, të gjeja forcën për të konkuruar dhe unë. Isha e vendosur të propozoja e të mbroja atë iniciative që unë e njoh mirë, e vuaj dhe që kërkoj ta shoh ndryshe edhe në sajë të kontributit tim. Angazhimet e mëparshme në lëvizjen për të drejtat e personave me aftësi ndryshe me ndihmonin. Nuk mendoja që do ishte e lehtë, por ven-

dosa të tentoja. Kur kujtoj përpjekjet e mia të një viti më parë, më vijnë ndërmend konkurrenca e fortë dhe orët plot ankth e punë për të qënë në listën e më të mirëve. U njoha me një eksperiencë të re, të vështirë sidomos për mua, por që më rriti edhe në aspektin e aplikimit të përgjegjshmërive dhe profesionalizmit.

Që në momentin e parë e deri sot që jam në përfundim të kësaj eksperiencë, më janë gjendur pranë shumë njerëz që besuan në sfidën time. Në mënyrë të veçantë, mikeshka ime Elda

Gjoka që ishte e gatshme të më ishte afër në çdo aktivitet e hap të kësaj iniciative, që me hartimin e planeve të punës, listën e bashkëpunëtorëve, e deri tek harta e lëvizjeve e impakti në shoqëri. Së bashku me të e patëm më të lehtë të bindim Fondacionin Shqiptar të të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar për të pranuar këtë iniciative si pjesë të programit dhe të aprovonte rolin si OJF mbështetëse. Por shpejt, edhe skuadra e Misionit të OSBE-së në Shqipëri iu bashkuan nismës time, që jo vetëm vendosi të shtojë rrethin e mbështetësve, por akordoi dhe një fond shtesë për ti dhënë më shumë vlerë fushatës informuese të çështjes që kisha marrë përsipër ta realizoja. U ndjeva vërtet mirë mes shumë miqve dhe dashamirësve. “Bota e Ndryshimit” kërkon një angazhim akoma më të madh e më serioz nga çfarë kisha patur më herët. Padyshim, është një eksperiencë që të vendos para provave të ndryshme dhe të rrit në shumë drejtime. Pasi dorëzova projekt-propozimin tim, prisja me padurim vlerësimin. Konkurrenca ishte e fortë dhe përzgjedhja ishte një proces me disa faza deri në shpalljen e fituesve. Ajo që më bënte të besojja dhe shpresoja ishte trajtimi që ndjeva përgjate gjithë këtij procesi. Ndihesha trajtuar e barabartë me çdo konkurent tjetër në lidhje me vëretjet, pyetjet e bëra, bisedat apo rekomandimet. Këtë do doja të shihja tek secili rast i trajtimit të një personi me aftësi të

kufizuar. Për këtë përpiqesha edhe në sfidën time të këtij viti që tentonte të promovonte zbatimin e të drejtave të personave me aftësi ndryshe. Momenti emocionues nuk vonoi. Ishte shumë bukur ta shihja veten mes 11 fituesve që kishin përpara një sfidë dhe një vit për ta çuar këtë sfidë aty ku unë dhe të tjerët kishim dëshiruar.

Përveç se një iniciative dhe përfshirje personale mbi çështje që e kam për zemër, kjo eksperiencë një vjeçare ka qenë gjithashtu një mundësi punësimi për mua. Sot, që gjëndem në përfundim të kësaj eksperience kujtoj me krenari sukseset dhe atë çfarë kam arritur së bashku me mbështetësit mi të shumtë. Kjo sfidë më ka vendosur në një tavolinë më shumë kryetarë bashkish, punonjës administrate, shumë aktivistë të shoqërisë civile apo gazetarë, me qindra studentë e nxënëses, me shumë bashkëqytetarë e me shumë të tjerë që donin dhe duan të më ndihmojnë që këtë sfidë ta çojmë më përpara.

Do doja shumë që nëpërmjet rezultateve të punës time të falenderoja të gjithë ata që më janë afër, duke filluar që me prindërit e mi, të cilët janë edhe kujdestarët e mi parësorë. U jam mirënjohese të gjithë vullnetarëve e kolegëve që nuk më lanë asnjë çast vetëm, të gjithë atyre që patën besim në aftësitë e mia. Është një ndjesi shumë e veçantë teksa rrethohesh nga njerëz që shohin përtej kufizimeve fizike.



Suela Lala, 28 vjeç
Vazhdon studimet në Fakultetin e
Drejtësisë të Universitetit të Tiranës



Bardhylka Kospiri, 55 vjeç
*Punon me Fondacionin Shqiptar
për të Drejtat e Personave
me Aftësi të Kufizuara*

Bardhylka Kospiri

Fituese e programit “Bota e Ndryshimit”
2009/10 të Fondacionit Vodafone Albania

Përtej pengesave

“Profesioni im i lënë “mënjane” më kthehet e më troket shpesh në ndërgjegjen dhe përgjegjësinë time, duke më kërkuar ta “përdor” në rrëzimin e çdo barriere ndërtimore që fatkeqësisht shoqëria dhe specialistët vazhdojnë të ngrenë në të përditëshmen e personave me aftësi ndryshe.

Kam patur një jetë aktive, një profesion që më bënte të udhëtoja vazhdimisht, që më jepte kënaqësi pambarrim. I gjithë ky aktivitet nuk më linte kohë të isha e vëmendëshme ndaj vetes, dhe që në fillim injorova shenjat e para të çrregullimeve shëndetësore, që më çuan drejt një diagnoze të rrallë dhe që do më sillte para situatave që kurrë nuk i kisha menduar. Ishte viti '92 kur ndjeva që forcat po më linin dhe sëmundja po triumfoje mbi mua. Kësaj gjëndjeje iu shtua edhe papunësia ime. Përjetova momente të vështira psikologjike dhe ekonomike.

Nuk arrija të shikoja e të vlerësoja as mbështetjen e afërmëve të mi, as ankthin e vështrimeve të trishtuara të fëmijëve që më ndiqnin në çdo cast. “Pse nuk provon? Edhe duke ndenjur në shtëpi mund të punosh. Unë do të të ndihmoj për të vendosur marrëdhëniet me grupin e punës.” – më tha im shoq. Nuk ishte rastësi dhe do ta kujtoj gjithmonë atë çast sepse kjo ishte një nga kthesat për të cilat kisha aq nevojë. E rrethuar nga njerëz që më kuptonin, nga të afërm e miq, shokë e shoqe që përpiqeshin të më lehtësonin përpjekjet e mija për të

qenë e dobishme, punoja dhe harrohesha mbi letra e vizatime me orë të tëra. Vetëm duke punuar harroja izolimin, mendohesha që të mos t'i jepja rëndësi ecurisë së sëmundjes që ecte me ritmin e saj dhe i përshtatesha dëmtimeve të reja që shfaqeshin duke ndërtuar ekuilibra të ri në marrëdhënie me të. Ishte shumë e rëndë kur kuptova që dora e djathtë s'po më bindej më pasi kjo do të thoshte jo më punë projektuese, jo më aktivitet. Por shpejt një shkëndijë shprese u shfaq sërish para meje. Krijimi i një burimi informacionesh e mbështetjeje për personat

“Doja të zgjoja tek ata ndjenjën e përgjegjësisë së inxhinierit se **çdo vijë e hedhur në projekt mund të përfshijë apo përjashtojë** nga shoqëria personat me aftësi ndryshe.”

me aftësi ndryshe, siç ishte Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Nuk do ta harroj takimin tim të parë në grupin e personave me aftësi ndryshe ndërsa flisja për vete dhe lotët më shoqëronin. E frymëzuar nga një videoklip që tregonte jetën e një vajzë pa duar e që mrekullisht punonte vetëm me ndihmën e këmbëve, iu riktheva punës projektuese duke përdorur dorën e majtë. Rezultatet më befasuan edhe vetë mua; nuk kishte asnjë diferencë në cilësi nga punimet e bëra nga të dyja duart. Ndërkohë merrja pjesë aktivisht me grupet e punës në fondacion, ku përvet të tjerave aty kuptoja se s’ishte koha për lotë. Ishte aty ku mësova se asgjë nuk pengonte as artistët e as shkencëtarët me aftësi fizike të kufizuara për të bërë mrekullira. Edhe pse sëmundja sot vazhdon me insistim të ecë në rrugën e saj, edhe pse e vetëdijëshme se energjitë që duhen për t’ju përgjigjur do të jenë gjithnjë e më të pakta, bëhem gjithnjë e më këmbëngulëse. Kjo këmbëngulje ka në bazën e saj ngrohtësinë dhe mbështetjen që

më ofron familja ime, ka përkrahjen e nxitjen e vazhdueshme të kolegëve të mi që më përkrahin me optimizëm dhe forcë për të mos u dorëzuar. Kjo këmbëngulje më bën të programoj ditën time në mënyre aktive. Sot, e përfshirë mes programeve të Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara që u vijonë në ndihmë një të ardhme më të mirë për këtë komunitet, shpesh e gjej veten mes inxhinieres dhe veprimtares në mbrojtje të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Profesionin e lënë “mënjatë” më kthehet e më troket shpesh në ndërgjegjen dhe përgjegjësinë time, duke më kërkuar ta “përdor” në rrëzimin e çdo barriere ndërtimore që fatkeqësisht shoqëria dhe specialistët vazhdojnë të ngrenë në të përditëshmen e personave me aftësi ndryshe. Një prej këtyre “trokitjeve” më nxiti të aplikoj, konkuroj e të fitoj në programin “Bota e Ndryshimit” të Fondacionit Vodafone Albania. Ky program më riktheu në një lëvizje të harruar, më përkuli sërisht mbi fletët e projekteve të objekteve të ndryshme

që po ndërtoheshin apo po planifiko-heshin për ndërtim për t’i plotësuar ato me elementet e përshtatshme për lëvizje të pavaruar për personat me aftësi të kufizuara. Ky program më takoi pas shumë vitesh me shumë ish-kolegë. Shpesh, kujtesa ime vihej në provë për të kërkuar e gjetur mes thinjave të tyre fytyra dhe emra të së shkuarës. Doja të zgjoja tek ata ndjenjën e përgjegjësisë së inxhinierit se çdo vijë e hedhur në projekt mund të përfshijë apo përjashtojë nga shoqëria personat me aftësi ndryshe. Ky program nxiti specialistët të flisnin si avokatë të të drejtave dhe “ktheu” në arkitektë drejtuesin dhe stafin e kësaj organizate. Ishte vetëm një vit, që u fut mes viteve të mi të punës, që më bëri të jem sërisht një projektuese, por që do kujtohet gjatë. Përmes kësaj eksperience njoha shumë njerëz dhe bera dhe shumë miq të rinj. Sot jemi më shumë e do bëjmë më shumë për vete e për shoqërinë. Nuk do t’i ndërroja me asgjë mëngjeset e punës në zyrat e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar ku e gjendur mes një stafi të mrekullueshëm, të përgatitur e të përkushtuar, pa kufinj mes aftësisë dhe paaftësisë, ku rezultatet e punës flasin për ecuri positive dhe të mësojnë si duhet të ndërtohen modelet e së ardhmes, kuptoj se asgjë nuk do të kisha arritur vetëm, brenda veçimit tim dëshpëruar të aftësisë së kufizuar.



unë jam

Histori suksesi të punësimit
të personave me aftësi të kufizuara



